



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

KOSOVO CENTER FOR PUBLIC SAFETY EDUCATION AND DEVELOPMENT
QENDRA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE EDUKIM DHE ZHVILLIM
KOSOVSKI CENTAR ZA JAVNU BEZBEDNOST OBRAZOVANJE I RAZVOJ

Duke u bazuar në rregulloren 2001/36, Urdhëresën administrative 2003/2 dhe Udhëzimin Administrativ 2003/1, Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim në Vushtrri shpallë:

K O N K U R S

Titulli i Pozitës: Udhëheqës i Divizionit të Lidershipit

Niveli i Pagës: 339.90€

Kontrata: Sipas Sherbimit Civil të Kosovës

Orar të Shkurtuar: Jo

Përgjegjësi mbikëqyrëse: Po

Qëllimi i DZHML është që të edukojë dhe zhvillojë menaxherët e institucioneve për Siguri Publike, duke zhvilluar nocionet e udhëheqjes. Zhvillimi i aftësive dhe marrëdhënieve ndërnjerëzore udhëheqëse janë prioritet i DZHML.

DZHML praktikon metodat demokratike moderne të udhëheqjes dhe menaxhimit, planifikimit strategjik dhe mendimit përmes programeve edukative të agjencioneve të sigurisë publike në Kosovë;

Strukturën e DZHML-së e përbëjnë tri njësi:

- Njësia e menaxhimit të vijës së parë;
- Njësia e menaxhimit të vijës së dytë;
- Njësia për vlerësimin e lidershipit;

Detyrat dhe Përgjegjësit:

- Dizajnon programe për aftësimin dhe edukimin e menaxherëve të nivelit të parë të menaxhmentit;
- Dizajnon programe për aftësimin dhe edukimin e menaxherëve të nivelit të mesëm të menaxhmentit;
- Dizajnon programe për aftësimin, edukimin dhe vlerësimin e menaxherëve të ardhshëm;
- Mbulon konceptet e menaxhimit bashkëkohor siç janë: aftësitë komunikuese, zgjidhja e problemit, formimi i ekipeve dhe planifikimi taktik;
- Mbulon konceptet siç janë: marrja e vendimeve, planet operative, incidentet e menaxhmentit kritik, projekt-menaxhimit dhe krijimin e ekipeve.

Kualifikimet Obligative:

- Diplom Universiteti (akridetuar dhe licencuar nga MASHT-it)
- Përvij pune së paku 2 vite.
- Njohuri të shkëlqyeshme të punës me kompjuter, me aplikim të programeve (Word, Excel, Power Point).
- Fleksibiliteti dhe aftësia për të punuar nën presion dhe brenda kohës së caktuar, janë të nevojshme.

Aftësitë :

- Aftësi të kordinimit/mbikëqyrjes të detyrave të punës për sektorët.
- Aftësi komunikuese, negociuese, bindëse dhe motivuese, për të realizuar detyrat e marra.
- Aftësi për të vlerësuar dhe përdorur iniciativën për t'iu përshtatur rrethanave të reja.
- Aftësi për t'u marrë me situatat komplekse dhe përballimin e tyre.
- Aftësi të planifikimit, raportimit dhe përcaktimit të prioriteteve.
- Aftësi të interpretimit të dispozitave ligjore.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e kërkesave mund të merren dhe të dorëzohen në Qendrën e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim respektivisht (ish shkolla policore) në zyrën e personelit me adresë Rr. Skënderbeu pn 42000, Vushtrri Data e mbylljes së kërkesave 15 ditë pas shpalljes në ndonjë nga gazetatat zyrtare të Kosovës.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit për aplikim nuk do të merren parasysh ndërsa kërkesat e pakompletuara dhe ata të cilët nuk i kanë kualifikimet adekuate nuk do të merren parasysh dhe nuk do të shqyrtohen dhe pranohen.

Tel. Kontaktues 028/570-008 lok 114 në rast të ndonjë paqartësie dhe këshille.

Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të ftohen për intervistim.

Shërbimi Civil i Kosovës i shërben të gjithë popullit të Kosovës dhe mirëpret aplikacionet prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve në Kosovë.